



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 21 janar 2016, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: z. Enver Hoxhaj, z. Qerim Bajrami, znj. Blerta Deliu-Kodra, z. Elmi Reçica, z. Glauk Konjufca.

Delegacioni i Grupit të Miqësisë nga Parlamenti i Austrisë: z. Hannes Weninger, z. Wolfgang Gerstl, z. Christoph Vavrik, z. Christoph Hagen, z. Gerhard Dorfler, deputetë; z. Roman Pable, z. Bernard Stocker, nga administrata e Parlamentit të Austrisë; z. Gernot Pfandler, ambasador dhe znj. Vera Fuchs, zv. ambasadore.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati, ZPRK; Fjolla Uka, KDI dhe Sanije Berisha, OSBE.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i Komisionit me Grupin e Miqësisë Austri – Kosovë.

Enver Hoxhaj i dëshiroi mirëseardhje delegacionit në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe prezantoi përbërjen e Komisionit. Shprehu kënaqësinë e veçantë për takimin e përbashkët me Grupin e Miqësisë të Parlamentit të Austrisë me Parlamentin e Kosovës.

Christoph Vavrik, fillimisht prezantoi anëtarët e delegacionit dhe njoftoi për takimet e deritanishme që i kanë pasur. Bëri të ditur se një delegacion parlamentar, si i tillë, ka ardhur për herë të parë në Kosovë dhe se ky është një hap i parë për thellimin e bashkëpunimit sistematik në nivelin parlamentar.

Lidhur me procesin e dialogut, theksoi se është arritur shumë, por në këtë aspekt Serbia ka bërë një progres për integrim në BE, ndërsa nuk luan rol konstruktiv lidhur me progresin e Kosovës për ndërkombëtarizim.

Ai, në vazhdim, kërkoi të informohet lidhur me marrëdhëniet Prishtinë – Beograd, Prishtinë – Athinë, Prishtinë – Shkup dhe raporti i Serbisë me Bosnjën e Hercegovinën.

Enver Hoxhaj, mes tjerash, tha se i jemi mirënjohës shtetit të Austrisë për kontributin që ka dhënë në raport me pavarësinë e Kosovës. Njëkohësisht, tha se jemi mirënjohës edhe për punën e madhe që shumë austriakë kanë bërë në konsolidimin e brendshëm të shtetësisë së Kosovës gjatë këtyre tetë viteve, qoftë si ushtarë, qoftë si ekspertë në misione të ndryshme civile dhe për zyrtarë të tjerë të cilët kanë qenë të involvuar në forcimin e subjektivitetit tonë ndërkombëtar.

Hannes Weninger, theksoi se Kosovën e sheh si shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, si pjesë të bashkësisë së shteteve evropiane, por ka përshtypjen se pritjet nga BE-ja, janë shumë më të mëdha dhe se detyrat politike të shtëpisë duhet të kryhen.

Përkrah kërkesën për mbështetjen e Kosovës nga BE-ja, organizatat ndërkombëtare dhe Austria, mirëpo theksoi se dialogu, gatishmëria për dialog, gatishmëria për të hyrë në kompromise për një partneritet stabil, me të gjitha shtetet fqinje, është një çështje dhe një detyrë e brendshme politike e Qeverisë së Kosovës dhe e Kuvendit, të cilën duhet ta bëjnë vetë.

Christoph Hagen, duke u ndërlidhur me fluksin e refugjatëve, tha se kjo paraqet vështirësi për BE-në dhe se çështja e liberalizimit të vizave shihet ende si një rrezik nga vendet e tjera.

Theksoi se është i befashuar, pozitivisht, për zhvillimet dhe progresin që është bërë në vend, megjithatë si problem e sheh çështjen e liberalizimit të vizave, korrupsionin dhe çështjet politike.

BE-ja pret që Kosova t'i kryejë edhe disa detyra, që të ketë vlerësime pozitive dhe të përshpejtohen të gjitha procedurat e nevojshme për integrim.

Wolfgang Gerstl, tha se Austria është angazhuar gjithëherë që të mbështesë Kosovën, duke i dhënë rëndësi të veçantë arsimit, telekomit dhe shumë fushave të tjera.

Jemi të vetëdijshëm për vendet e BE-së, që kanë qëndrime të ndryshme për shtetet joanëtare, mirëpo kjo nuk mund të qëndrojë në këtë formë. Nuk është e mundur që edhe Rusia të ketë ndikim kaq të madh në rajonin e Mesdheut dhe ne duhet të jemi aktivë, në kuadër të këtyre kufijve, si dhe të mos pranojmë ndërhyrje të tilla nga jashtë Evropës.

Kërkoi të informohet, se cilat janë qasjet dhe qëndrimet për ndikimet, të cilat vijnë nga Evropa Lindore, apo nga rajonet tjera të Ballkanit, si Turqia.

Christoph Vavrik, çështja e liberalizimit të vizave është një çështje teknike, që duhet përmbushur dhe që e prekin më shumë Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Theksoi se nga viti i kaluar ka rënie të kriminalitetit të kosovarëve në Austri dhe se rreth 60 000 kosovarë kanë marrë rrugën për në Austri, Gjermani dhe vende tjera të BE-së, të cilët mund të jenë pjesë e veprimeve kriminale atje. Po ashtu, tha se është me rëndësi që këto çështje të trajtohen dhe sqarohen, që të parandalohet eksportimi i kriminalitetit jashtë vendit. Shtroi çështjen se a mund të luftohet kriminaliteti në vend me EULEX-in apo pa EULEX-in, pra sa më shumë vetëvendosje, aq më tepër do të keni mundësi për të arritur perspektivë në vend dhe për t'u integruar në BE.

Krahasimi që po i bëhet Asociacionit të komunave me Bosnjën, mendoj që nuk është krahasim i mirë për situatën e tanishme në Kosovë, sepse ne po flasim për Kosovën, dhe jo për një republikë të brendshme si pjesë të Kosovës, tha Vavrik.

Blerta Deliu-Kodra, mes tjerash theksoi se Kosova po kalon në një proces jo shumë të letë në qarqe politike, sepse përveç dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, kemi edhe obligime në përmbushjen e kritereve për liberalizimin e vizave. Në mesin e shumë shqetësimeve tona, theksoi se shqetësim

është papunësia e madhe, për çka politika kosovare po mundohet të krijojë një ambient stabil për hapje të vendeve të reja të punës. Një numër i madh i të rinjve tanë, nuk kanë pasur mundësinë të dalin apo të studiojnë jashtë, gjë që Evropa duhet të kuptojë vullnetin tonë të mirë, që edhe ne si gjithë qytetarët e tjerë evropianë, të kemi të drejtën e lëvizjes së lirë. Theksoi se presim një rekomandim pozitiv për liberalizimin e vizave, që të kemi mundësinë që të lëvizim të lirë dhe të shohim përvojat e shteteve evropiane.

Qerim Bajrami, në emër të komuniteteve nga GP-6+, shprehu kënaqësinë për vizitën e delegacionit të Grupit të Miqësisë të Parlamentit të Austrisë me Kuvendin e Kosovës. Austrinë e konsideron shtet mik të rëndësishëm, që e përkrahu në vazhdimësi Kosovën dhe shpreson se do ta mbështesë edhe më tutje, veçanërisht lidhur me liberalizimin e vizave. Theksoi se ne kemi një numër të madh të qytetarëve tanë jashtë vendit, të cilët kemi nevojë t'i vizitojmë. Lidhur me raportet në mes të Kosovës e Serbisë, në mes të tjerash, tha se këto raporte kërkojnë një studim më të thellë dhe shpreson në ndikimin e delegacionit për mbështetje të Kosovës, që sa më parë të jetë pjesë e Evropës.

Glauk Konjufca, falënderoi delegacionin austriak për rolin e shtetit të Austrisë dhe ndihmën në të gjitha proceset historike në të cilat ka kaluar Kosova, e sidomos të historisë më të re të saj. Kosova ka shumë probleme. Fillimisht, me funksionimin e drejtësisë, sepse ende nuk është arritur të konsolidohet një sistem i drejtë i drejtësisë në Kosovë. Për shkak të kësaj pamundësie, theksoi se korrupsioni është vetëm konsekuencë. Po ashtu, zhvillimi ekonomik ka ngecur, papunësia dhe varfëria janë shumë të mëdha dhe se asnjë qeveri, deri më tani, nuk ka arritur të gjejë një çelës të qëndrueshëm të zhvillimit të Kosovës. Modeli i qeverisjes ekonomike të Kosovës, është në njëfarë mënyre paqja sociale, pa ngritje ekonomike, theksoi Konjufca.

Kategori tjetër e problemeve në Kosovë, tha se janë problemet që ndërlidhen me integritet evropian dhe liberalizimin e vizave, për të cilat Kosova është e interesuar. Po ashtu, theksoi se të gjitha partitë politike në Kosovë, edhe pse i kanë qëndrimet e tyre të ndryshme, të gjitha janë pro evropiane dhe e shohin të ardhmen e Kosovës në BE. Qeveria do të mund të bënte më shumë, në mënyrë që më shpejt të përmbushen obligimet drejt procesit të liberalizimit të vizave. Si sfidë të katërt dhe kryesore të shtet-ndërtimit të Kosovës, i konsideron Gjykatën Speciale dhe dialogun me Serbinë. Theksoi se subjekti i tij politik ka qasje kritike ndaj këtyre dy proceseve. Me Gjykatën Speciale, theksoi se është bërë një padrejtësi e madhe, pasi që është vendosur vetëm njëra palë si subjekt i fajësisë, ku UÇK-ja parashihet problemi dhe përfaqësuesit e saj duhen të gjykojnë. Sa i përket dialogut me Serbinë, tha se ne e kemi fqinj dhe e njohim. Plani nacional i saj është krijimi i një etniteti etnik në Kosovë, i cili kontrollohet prej Beogradit, që do të krijojë obstrukcione në shtet-ndërtimin e ardhshëm të Kosovës. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe në pozicionin aktual që mban ajo ndaj Kosovës, që t'i mundësohet një instrument çfarë ajo e ka në Bosnjë e Hercegovinë, kjo do të jetë një pakujdesi e madhe e BE-së në konceptin e saj për siguri në rajon. Sipas Planit të Ahtisaarit, pakica serbe në Kosovë ka shumë të drejta, të cilat nuk i ka asnjë pakicë në Evropë. Gjithashtu, konsideron se e drejta e vetos në Kuvendin e Kosovës, nuk është e drejtë e pakicave, ajo është përtej të drejtave të pakicave, përtej dialogut. Po ashtu, tha se “Zajednica” është përtej “minority act”, betejë e Serbisë për ta kontrolluar Kosovën, dhe në këtë drejtim, kërkoi nga përfaqësuesit austriakë të japin kontributin e tyre.

Elmi Reçica, theksoi se Kosova është një shtet i ri dhe domosdo, si shtet i ri, ka mjaft sfida. Duke u ndërlidhur me çështjen e kompromiseve, tha se ne kemi bërë kompromise dhe kemi qenë shumë kooperativë, meqë bisedimet me Serbinë kanë filluar nga një Rezolutë e KS të OKB-së, me ndërmjetësimin e BE-së. Ne kemi filluar bisedimet përkundër shumë mundësive, të cilat u kemi

ofruar pakicave, por pala serbe, nga ana tjetër, nuk ka treguar gatishmërinë në realizimin e marrëveshjeve. Vazhdimin e dialogut, tha se nuk e kemi vënë në diskutim, pavarësisht sfidave, kemi bashkëpunuar në të mirën e marrëdhënieve të rajonit dhe të BE-së.

Ka qenë e paimagjinueshme për ne, që pala serbe të dalë kundër anëtarësimit tonë në UNESCO, përderisa ata thirren se pjesën dërmuese të monumenteve të kulturës e trashëgimisë së tyre historike i kanë në Kosovë. Po ashtu, vuri në pah se Kosova është shtet shumetnik e multikulturor dhe se jemi të interesuar që feja të mbetet ashtu siç ka qenë dhe siç e kemi trashëguar, pa ndryshime e ndikime. Ne kemi orientim perëndimor në çdo koncept dhe kemi synim integrimet evropiane, liberalizimin e vizave dhe zhvillimin ekonomik. Po ashtu, tha se kemi gatishmërinë që t'i shtyjme proceset përpara, dialogun me Serbinë e Gjykatën Speciale, duke kërkuar që të gjitha çështjet të diskutohen në Kuvend.

Enver Hoxhaj, theksoi se është shumë e rëndësishme mbështetja e palës austriake, që këtë vit, qytetarët e Kosovës të kenë mundësinë e lëvizjes pa viza drejt Evropës, duke cekur se janë plotësuar të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave, ndërsa jemi vendi i vetëm në rajon, i izoluar. Sa i përket dialogut me Serbinë, tha se kemi nuanca të ndryshme, por pikëpamje të njëjta dhe mendojmë se dialogu duhet të kalojë në një fazë të re, në të cilën duhet të ketë parametra të qartë se ku do të arrijë ky dialog. Jemi të shqetësuar se pesë vende të BE-së ende nuk e kanë njohur Kosovën, dhe tani pasi që e kemi nënshkruar MSA-në, nëse këto vende deri në vitin e ardhshëm nuk e njohin Kosovën, ne nuk mund të aplikojmë për statusin e vendit kandidat. Kërkoj mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme evropiane e rajonale dhe në seancën plenare të Këshillit të Evropës, që do të mbahet në Strasburg, për miratimin e rezolutës, që do të jetë në favor të Kosovës. Bëri të ditur se do të përgatitet një dokument mbi bashkëpunimin Kosovë-Austri, do të themelohet Grupi i Miqësisë, i cili do të vizitojë Austrinë gjatë vitit 2016, si dhe do të formësohen marrëdhëniet bilaterale gjatë këtij viti.

Christoph Vavrik, falënderoi Komisionin për mirënjohjet ndaj Austrisë, për mbështetjen që i ka dhënë shtetit të Kosovës, duke theksuar se kjo mbështetje e Austrisë për konsolidimin e mëtejshëm të Kosovës në suaza evropiane, do të vazhdojë.

Lidhur me Këshillin e Evropës, tha se këtë çështje do ta trajtojmë si çështje me rëndësi, ndërsa ndër prioritetet e ministrit të Jashtëm të Austrisë, është edhe Ballkani Perëndimor, ku edhe Kosova është prioritet i politikës së jashtme austriake.

Gjithashtu, theksoi se do të mbështesin kërkesën e Kosovës për liberalizimin e vizave, por duhet të jemi aktivë në këtë drejtim, të gjendët gjuhë e përbashkët politike në Kosovë, për t'u anashkaluar gjendja e krijuar.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj